

## Rezultate kryesore nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës Tremujori i dytë 2013


Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një vrojtim statistikor që kryhet pranë familjeve. Në vitet 2007-2011 Anketa e Forcave të Punës është kryer nga INSTAT me periodicitet vjetor. Në vitin 2012, Anketa e Forcave të Punës u projektua si një anketë pilot për marrjen e vlerësimeve tremujore për punësimin dhe papunësinë në nivel kombëtar ndërsa duke filluar nga tremujori i parë 2013 e në vazhdim, ATFP do të përdoret për të nxjerrë tregues mbi tregun e punës në Shqipëri me periodicitet tremujor.

Objektivi kryesor i ATFP-së është të japë informacion mbi situatën e tregut të punës në Shqipëri i cili përdoret për të hartuar politikat e tregut të punës dhe për vlerësimin e efektshmërisë së tyre, si dhe për të kënaqur nevojat e përdoruesve të statistikave për të dhëna të përditësuara mbi dinamikën e tregut të punës.

### PUNËSIMI

Gjatë tremujorit të dytë 2013 në Shqipëri 63.2 përqind e popullsisë në moshë pune ishte aktive në tregun e punës, pra e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për femrat ishte 54.3 përqind ndërsa për meshkujt 73.8 përqind. Krahasur me tremujorin e parë 2013, pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është ulur me 1 përqind, ndërsa pjesëmarrja e meshkujve është rritur me 1.3 përqind (shih Tabelën 1).



Në tremujorin e dytë 2013 shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ishte 41.4 përqind ndërsa për popullsinë 30-64 vjeç ky tregues ishte 75.6 përqind. Nga tremujori i parë 2013 në të dytin, nuk ka patur ndryshime të rëndësishme përse i përket pjesëmarrjes në tregun e punës.

Për popullsinë në moshë pune (15-64 vjeç) vihet re një rënie në shkallën e punësimit nga 58.8 përqind në tremujorin e parë 2012 në 53.8 përqind në tremujorin e dytë 2013 (shih Tabelën 2). Shkalla e punësimit për meshkujt vazhdon të jetë më e lartë sesa për femrat duke shënuar kështu një diferencë mesatare prej 12.7 përqind.

Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç gjatë tremujorit të dytë 2013 shkalla e punësimit ishte 31.6 përqind ndërsa për popullsinë 30-64 vjeç ky tregues ishte 66.4 përqind. Krahasuar me tremujorin e dytë 2012, shkalla e punësimit të meshkujve 30-64 vjeç është ulur me 1.4 përqind, ndërsa për femrat e kësaj grupmoshe nuk ka ndonjë ndryshim nga tremujori i vitit të mëparshëm. Punësimi gjatë tremujorit të dytë 2013 pësoi një rënie prej 0.6 përqind krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti.

**Tabela 1: Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës sipas grupmoshave dhe gjinisë**

	Shkalla e punësimit			Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>15-64 vjeç</b>						
Tr.1/12	58.8	65.1	52.6	67.9	76.0	59.9
Tr.2/12	56.9	63.7	50.1	66.1	75.1	57.2
Tr.3/12	55.2	62.2	48.2	64.2	73.2	55.2
Tr.4/12	54.5	61.6	47.3	63.6	73.0	54.3
Tr.1/13	54.1	60.4	48.2	63.2	71.8	55.3
Tr.2/13	53.8	60.5	47.8	63.2	73.1	54.2
<b>15-29 vjeç</b>						
Tr.1/12	39.4	44.9	33.5	51.1	58.8	42.9
Tr.2/12	37.7	42.8	32.2	49.6	58.2	40.4
Tr.3/12	33.2	37.5	28.7	45.7	53.7	37.1
Tr.4/12	32.8	36.5	28.8	44.3	51.8	36.3
Tr.1/13	31.0	36.2	25.9	41.2	49.2	33.5
Tr.2/13	31.6	36.7	26.7	41.3	50.6	32.4
<b>30-64 vjeç</b>						
Tr.1/12	69.4	76.9	62.2	77.1	86.1	68.6
Tr.2/12	67.6	76.1	59.4	75.3	85.0	65.9
Tr.3/12	67.8	77.2	58.9	74.8	85.1	65.0
Tr.4/12	66.9	76.9	57.4	74.7	85.9	64.1
Tr.1/13	66.8	74.5	60.0	75.3	84.9	66.9
Tr.2/13	66.4	74.8	59.1	75.6	86.4	66.0

Burimi i informacionit: Anketa Tremujore e Forcave të Punës, 2012-2013

## Struktura e punësimit sipas statusit në punësim

Në tremujorin e parë 2013 të punësuarit me pagë përbënin 38.3 përqind të të punësuarve. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të mëparshëm numri i të punësuarve me pagë u rrit me 1.6 përqind, ndërsa nga tremujori i parë 2013 nuk ka patur ndryshime.

Përqindja e të punësuarve me pagë meshkuj, në tremujorin e dytë 2013 ishte 42.2 ndërsa të punësuarat me pagë femra përbënin 33.7 përqind të të punësuarve. Ndërsa vihet re që meshkujt e vetëpunësuar pa të punësuar kundrejt një page përbënin 29.8 përqind të totalit të të punësuarve meshkuj dhe punëtorët pa pagesë të familjes 25.9 përqind. E kundërta ndodh në punësimin e femrave, ku 49.5 përqind e të punësuarve femra janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes dhe 16.2 përqind e tyre janë të vetëpunësuar pa të punësuar kundrejt një page. Pra nga tremujori i parë 2013 në të dytin është rritur përqindja e femrave të punësuar si punëtore pa pagesë në biznesin e familjes.

**Tabela 2: Struktura e punësimit sipas statusit në punësim dhe gjinisë**

(përqindje në kolonë)

	Tr.1/12	Tr.2/12	Tr.3/12	Tr.4/12	Tr.1/13	Tr.2/13
<b>Popullsia 15-64 vjeç</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
I punësuar me pagë	37.9	36.7	36.7	36.8	38.4	38.3
I vetëpunësuar dhe punëdhënës	1.5	1.7	1.8	1.4	2.0	1.4
I vetëpunësuar pa të punësuar me pagë	27.0	25.2	24.0	24.7	24.4	23.4
Punëtor pa pagesë i familjes	33.7	36.5	37.5	37.1	35.2	36.9
<b>Meshkuj</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
I punësuar me pagë	42.2	40.8	41.4	41.9	41.8	42.2
I vetëpunësuar dhe punëdhënës	1.9	2.3	2.2	1.6	2.4	2.1
I vetëpunësuar pa të punësuar me pagë	33.7	32.4	30.1	31.0	30.8	29.8
Punëtor pa pagesë i familjes	22.2	24.5	26.4	25.5	24.9	25.9
<b>Femra</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
I punësuar me pagë	32.5	31.4	30.7	30.3	34.5	33.7
I vetëpunësuar dhe punëdhënës	0.9	0.8	1.3	1.0	1.6	0.6
I vetëpunësuar pa të punësuar me pagë	18.7	16.0	16.2	16.6	17.0	16.2
Punëtor pa pagesë i familjes	47.9	51.8	51.7	52.1	47.0	49.5
<b>Popullsia 15-29 vjeç</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
I punësuar me pagë	34.1	36.8	36.9	36.2	41.7	41.1
I vetëpunësuar dhe punëdhënës	0.7	0.4	0.2	0.2	1.5	0.4
I vetëpunësuar pa të punësuar me pagë	14.1	12.9	16.0	13.9	12.0	10.7
Punëtor pa pagesë i familjes	51.0	49.9	46.9	49.7	44.7	47.9
<b>Popullsia 30-64 vjeç</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
I punësuar me pagë	39.0	36.6	36.7	37.0	37.5	37.5
I vetëpunësuar dhe punëdhënës	1.7	2.0	2.3	1.7	2.2	1.7
I vetëpunësuar pa të punësuar me pagë	30.9	29.0	26.2	27.8	27.6	26.8
Punëtor pa pagesë i familjes	28.4	32.4	34.9	33.6	32.8	34.0

Burimi i informacionit: Anketa Tremujore e Forcave të Punës, 2012-2013

Ndër të rinjtë e punësuar (15-29 vjeç), 41.1 përqind ishin të punësuar me pagë, 0.4 përqind ishin të vetëpunësuar me të punësuar kundrejt një page, 47.9 përqind punonin në biznesin e familjes si punëtorë pa pagesë, ndërsa pjesa tjetër ishin të vetëpunësuar pa të punësuar kundrejt një page.

**Struktura sektoriale e punësimit.** Sipas të dhënave të ATFP-së, në tremujorin e dytë 2013 rreth 36 përqind e personave të punësuar (të punësuar me pagë dhe të vetëpunësuar) punuan në sektorin e shërbimeve. Punësimi në këtë sektor mbetet pothuajse i njëjtë që nga tremujori i dytë 2012 me disa luhatshmëri të vogla. Punësimi në sektorin e shërbimeve të tregut si tregtia, transporti, aktivitetet financiare etj, përbënte 19.7 përqind të punësimit total, në sektorin e shërbimeve jo të tregut, punësimi zinte afro 15.2 përqind të punësimit total dhe në sektorin e bujqësisë përbënte 48.8 përqind të punësimit.

**Tabela 3: Struktura e punësimit sipas aktivitetit ekonomik dhe gjinisë**  
(përqindje në kolonë)

	Tr.1/12	Tr.2/12	Tr.3/12	Tr.4/12	Tr.1/13	Tr.2/13
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
Bujqësi	45.6	47.2	48.3	48.7	48.7	48.8
Industri	17.3	17.0	16.2	15.5	16.0	16.3
Shërbimet e tregut	21.6	20.4	20.5	20.5	19.3	19.7
Shërbimet jo të tregut	15.5	15.4	15.0	15.2	16.0	15.2
<b>Meshkuj</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
Bujqësi	37.5	38.6	39.3	39.6	40.9	40.5
Industri	23.3	23.6	22.1	21.4	22.3	21.8
Shërbimet e tregut	25.0	23.6	24.6	24.9	22.5	23.9
Shërbimet jo të tregut	14.1	14.2	14.0	14.1	14.3	13.7
<b>Femra</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
Bujqësi	55.5	58.1	59.9	60.6	57.9	58.5
Industri	9.8	8.6	8.6	7.9	8.6	9.8
Shërbimet e tregut	17.3	16.3	15.3	14.8	15.6	14.8
Shërbimet jo të tregut	17.3	17.0	16.2	16.7	17.9	16.9

Burimi i informacionit: Anketa Tremujore e Forcave të Punës, 2012-2013

Në tremujorin e dytë 2013, 58.5 përqind e femrave të punësuar ishin të angazhuara në aktivitete bujqësore e blegtorale, 14.8 përqind në aktivitete të tilla si tregtia me shumicë dhe pakicë, hotele dhe restorantet ndërmjetësimi monetar dhe financiar, etj.

Gjatë tremujorit të dytë 2013, 40.5 përqind e meshkujve të punësuar punonin në sektorin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit (shih tabelën 3).

## PAPUNËSIA

Sipas vlerësimeve të marra nga ATFP, gjatë tremujorit të dytë 2013 shkalla e papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç në Shqipëri ishte 14.8 përqind (shih Tabelën 4), ndërsa shkalla e papunësisë afatgjatë ishte 11.3 përqind.

Krahasur me tremujorin e parë 2012 shkalla e papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç është rritur me 3 pikë përqindje. Shkalla e papunësisë vlerësohet të jetë më e lartë për meshkujt sesa për femrat, duke reflektuar një nivel më të lartë të kërkimit të punës nga ana e meshkujve dhe një nivel më të lartë inaktiviteti në lidhje me tregun e punës nga ana e femrave. Për meshkujt shkalla e papunësisë u rrit nga 15.8 përqind në tremujorin e parë 2013 në 17.1 përqind në tremujorin e dytë. Ndërsa për femrat pati një rënie nga 12.9 përqind në tremujorin e parë në 11.9 përqind në tremujorin e dytë.

**Tabela 4: Shkalla e papunësisë dhe shkalla e papunësisë afatgjatë sipas grupmoshave dhe gjinisë**

	Shkalla e papunësisë			Shkalla e papunësisë afatgjatë		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>15-64 vjeç</b>						
Tr.1/12	13.4	14.3	12.2	10.0	10.1	9.7
Tr.2/12	13.9	15.1	12.4	10.7	11.2	9.9
Tr.3/12	14.0	15.1	12.6	10.7	11.2	10.1
Tr.4/12	14.4	15.6	12.8	11.7	12.7	10.5
Tr.1/13	14.5	15.8	12.9	11.0	11.5	10.5
Tr.2/13	14.8	17.1	11.9	11.3	12.6	9.7
<b>15-29 vjeç</b>						
Tr.1/12	22.9	23.6	21.8	14.5	14.8	14.0
Tr.2/12	24.1	26.4	20.4	16.7	18.2	14.3
Tr.3/12	27.3	30.2	22.8	19.0	20.5	16.7
Tr.4/12	26.0	29.5	20.7	19.3	22.7	14.1
Tr.1/13	24.9	26.5	22.7	17.4	18.0	16.5
Tr.2/13	23.6	27.5	17.7	16.3	18.7	12.7
<b>30-64 vjeç</b>						
Tr.1/12	10.0	10.6	9.2	8.3	8.3	8.4
Tr.2/12	10.2	10.5	9.9	8.4	8.4	8.5
Tr.3/12	9.3	9.3	9.4	7.9	7.7	8.1
Tr.4/12	10.5	10.5	10.4	9.2	9.0	9.4
Tr.1/13	11.3	12.3	10.2	9.1	9.3	8.9
Tr.2/13	12.1	13.5	10.4	9.8	10.5	9.0

Burimi i informacionit: Anketa Tremujore e Forcave të Punës, 2012-2013

Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë në tremujorin e dytë 2013 ishte 23.6 përqind. Krahasuar me tremujorin e dytë 2012, shkalla e papunësisë për të rinjtë nuk ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Raporti i të rinjve 15-29 vjeç të papunë ndaj popullsisë së të njëjtës grupmoshë në tremujorin e dytë të 2013 ishte mesatarisht 12.5 përqind.

Për popullsinë 30-64 vjeç në tremujorin e parë 2013 shkalla e papunësisë ishte 12.1 përqind dhe shkalla e papunësisë afatgjatë ishte 9.8 përqind.

Shumica e të papunëve u drejtohen të afërmeve apo miqve/shokëve për të gjetur një punë. Kjo metodë e kërkimit për punë është e kombinuar dhe me aplikimin direkt tek një punëdhënës si dhe me vendosjen e lajmërimeve në gazeta, studimin e lajmërimeve për vende të lira pune në gazeta etj.

## **POPULLSIA EKONOMIKISHT JO-AKTIVE**

Gjatë tremujorit të dytë 2013, popullsia e moshës 15-64 vjeç e klasifikuar si ekonomikisht jo-aktive përbënte 39.9 përqind të popullsisë në moshë pune. Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan që ishin se ishin nxënës/studentë ose në trajnim përbënin 40 përqind të popullsisë ekonomikisht jo aktive. Ndërsa brenda grupit të të rinjve ekonomikisht jo aktivë 69.1 përqind ishin nxënës/studentë ose në trainim.

Në tremujorin e dytë 2013, 16.5 përqind e popullsisë ekonomikisht jo aktive të moshës 15-64 vjeç ishin duke përbushur detyrat shtëpiake.

Ndër femrat e klasifikuara si ekonomikisht jo-aktive, 24.6 përqind deklaruan që nuk ishin aktive në tregun e punës sepse po përbushnin detyrat shtëpiake. Ndërsa tek meshkujt, këtë status e kanë vetëm 1.3 përqind e tyre.

Në tremujorin e dytë 2013, sipas vlerësimeve të ATFP-së, 15.5 përqind e popullsisë (15-64 vjeç) ekonomikisht jo-aktive deklaruan që nuk po kërkonin punë për arsye se besonin që nuk ka punë të disponueshme. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ka një rritje prej 1.3 përqind të të papunëve të dekurajuar, rritje kjo më e theksuar tek femrat.

Ndër të rinjtë (15-29 vjeç) ekonomikisht jo aktivë 11.2 përqind e tyre klasifikohen si të papunë të dekurajuar ndërsa në popullsinë më të rritur të moshës 30-64 vjeç ky grup përbënte 21.3 përqind të popullsisë ekonomikisht jo-aktive të kësaj grupmoshe.

Rreth 10 përqind e popullsisë ekonomikisht jo-aktive e moshës 15-64 vjeç ishin në pension ndërsa 5.2 përqind ishin në paaftësi të përhershme.

**Tabela 5: Struktura e popullsisë 15-64 vjeç ekonomikisht joaktive, 2012-2013**

	Tr.1/12	Tr.2/12	Tr.3/12	Tr.4/12	Tr.1/13	Tr.2/13
<b>Popullsia 15-64 vjeç</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
Në arsim ose trajnim		34.9	35.9	37.6	39.0	39.9
Në pension		10.6	9.8	9.5	11.0	9.8
Beson që nuk ka punë të disponueshme		4.4	17.3	19.4	14.2	15.5
Në paaftësi të përhershme		5.6	5.5	4.9	5.7	5.2
Duke përmbushur detyrat shtëpiake		18.2	16.5	17.1	16.1	16.5
Tjetër		26.4	15.0	11.6	14.0	13.1
<b>Meshkuj</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
Në arsim ose trajnim	48.1	46.8	46.6	50.4	46.8	52.7
Në pension	11.2	9.0	8.1	6.8	8.8	7.8
Beson që nuk ka punë të disponueshme	2.7	5.4	17.3	20.3	17.4	16.4
Në paaftësi të përhershme	10.1	9.7	10.8	8.7	8.6	8.9
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	0.3	0.1	0.1	0.2	0.9	1.3
Tjetër	27.7	29.0	17.2	13.6	17.6	12.8
<b>Femra</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>
Në arsim ose trajnim	28.3	27.9	29.5	30.0	34.5	33.0
Në pension	12.0	11.5	10.8	11.0	12.3	10.9
Beson që nuk ka punë të disponueshme	3.7	3.8	17.3	18.8	12.4	15.0
Në paaftësi të përhershme	3.4	3.2	2.4	2.7	4.0	3.2
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	23.3	28.7	26.3	27.0	24.9	24.6
Tjetër	29.2	24.9	13.7	10.5	11.9	13.3
<b>Popullsia 15-29 vjeç</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	100
Në arsim ose trajnim	66.1	63.8	64.7	67.2	68.5	69.1
Në pension	0.2	0.0	0.2	0.0	0.1	0.1
Beson që nuk ka punë të disponueshme	2.1	3.2	10.1	11.0	11.1	11.2
Në paaftësi të përhershme	1.9	1.5	1.6	1.5	1.8	1.5
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	8.9	10.9	8.4	8.3	8.4	7.9
Tjetër	20.8	20.6	15.0	11.9	10.1	10.2
<b>Popullsia 30-64 vjeç</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	100
Në arsim ose trajnim	0.3	2.1	0.1	0.1	0.2	0.2
Në pension	25.1	22.5	21.7	21.4	25.3	23.0
Beson që nuk ka punë të disponueshme	4.8	5.7	26.2	29.9	18.3	21.3
Në paaftësi të përhershme	10.5	10.3	10.4	9.2	10.8	10.3
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	21.4	26.6	26.5	28.2	26.3	28.2
Tjetër	37.8	32.9	15.1	11.3	19.1	17.0

Burimi i informacionit: Anketa Tremujore e Forcave të Punës, 2012-2013

## **METODOLOGJI DHE DEFINICIONE**

Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATFP) është një anketë që kryhet pranë familjeve. Kalimi nga kryerja e anketës me periodicitet vjetor në anketë të vazhdueshme u bë me qëllim që të mundësohet marrja e vlerësimeve tremujore të treguesve kryesorë për tregun e punës. Ky informacion i përditësuar periodikisht çdo tremujor ofron mundësinë e analizimit të dinamikës së tregut të punës.

Për ATFP-në përdoret një strukturë e alternuar zgjedhjeje (Rotational sampling design), përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Intervistat për të njëjtën familje janë planifikuar të kryhen ekzaktësisht pas 13 javëve, kështu intervista e pestë kryhet një vit më pas intervistës së parë. Sipas strukturës së alternuar të zgjedhjes në çdo tremujor një e pesta e familjeve të zgjedhura janë të reja dhe 80 përqind e familjeve janë të njëjta. Pra, çdo tremujor në kampionin e zgjedhur për anketën shtohen 1008 familje të reja dhe hiqet po i njëjti numër familjesh që është intervistuar në 5 tremujorë të njëpasnjëshëm.

Masa e kampionit të zgjedhur për anketim është 5040 familje për çdo tremujor. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave gjeografike (të zgjedhura në hapin e parë) zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 8 familjesh.

Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë gjithë muajve të vitit. Në familjet e zgjedhura u anketuan nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart. Mbledhja e të dhënave bëhet duke përdorur APD (Asistenti Personal Dixhital) i cili është një kompjuter i vogël dore.

Pyetësi i ATFP-së është hartuar me asistencën teknike të EUROSTAT-it dhe ai është në përputhje të plotë me rekomandimet dhe rregulloret\* e EUROSTAT-it. Nga ana metodologjike anketa plotëson kërkesat e EUROSTAT-it si ato që lidhen me përfaqësimin e kampionit, koeficientët e variacionit të treguesve kryesorë, hartimin e pyetësit, si dhe me procedurat e peshimit të të dhënave. Për klasifikimin e personave 15 vjeç e lart si të punës u zbatuan definicionet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe të EUROSTAT-it.

**Të punësuar** janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës.

Të punësuar janë konsideruar edhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkoshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trainim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet që (a) kohëzgjatja e



mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 përqind ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak.

Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar.

**Të papunë** konsiderohen personat që ishin:

- (a) *pa punë gjatë javës së referencës* (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi).
- (b) *aktualisht të disponueshëm për të punuar* (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës).
- (c) *duke kërkuar punë në mënyrë aktive* (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) *ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti* (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifike për të kërkuar punë konsiderohen:

- kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontakt me një agjensi private punësimi për të gjetur punë
- aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmeve, sindikatave etj.
- vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta
- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, liçenca ose burime financiare

**Popullsia në moshë pune** është popullsia 15-64 vjeç.

**Forca e Punës** përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

**Popullsia jo-ekonomikisht aktive** përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtepiakë, në shërbim të detyrueshëm ushtarak, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

**Shkalla e punësimit** është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

**Shkalla e papunësisë** është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

**Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës** është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

Grupimi i seksioneve të NACE Rev1 në Tabelën 3:

- **Sektori i industrisë** përbëhet nga seksionet C-F (industria nxjerrëse; industria përpunuese; prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit; ndërtimi).
- **Sektori i shërbimeve të tregut** përbëhet nga seksionet G-K (tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave; hotele dhe restorantet; transportet, magazinimi dhe komunikacioni; ndërmjetësimi monetar dhe financiar; pasuritë e patundshme).
- **Sektori i shërbimeve jo të tregut** përbëhet nga seksionet L-Q (administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi shoqëror i detyruar; arsimit; shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale; aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual; shërbime në shtëpi; aktivitete të organizmave ndërkombëtare).

---

\* Rregullorja e Këshillit Europian (EC) Nr 577/98 dhe rishikimet e lidhura me të.